



# QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS

Qendra Kinematografike e Kosovës, në bazë të nenit 33, 34 dhe 35 të Ligjit Nr. 2004/22 për Kinematografinë dhe Rregullores Nr 07/2016 për suvencionimin e projekteve filmike të QKK-së shpall:

## **KONKURS PËR ZHVILLIM TË SKENARIT – PROJEKTIT, PËR FILM TË METRAZHIT TË GJATË (ARTISTIK, DOKUMENTAR DHE TË ANIMUAR)** **Ref. Nr. QKK-07/2018**

Për Subvencionim të projekteve kinematografike të zhvillimit të skenarit – projektit për film të metrazhit të gjatë, për vitin 2018.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë personat juridik, vendës ose të huaj, të regjistruar në Kosovë si subjekt biznesi për prodhimin e filmit dhe paraprakisht të regjistruar në QKK dhe që i plotësojnë kushtet e kërkuara me këtë konkurs.

**I. Aplikimi bëhet online në linkun [www.qkk-rks.com](http://www.qkk-rks.com) , ku ndër të tjera në aplikim kërkohen:**

1. Testi i kulturës
2. Buxheti
3. Sinopsisi
4. Tritmenti ose Skenari
5. CV të autorëve kryesorë
6. Pagesa e aplikimit 50€ (pesëdhjetë euro)

### **II. KUFIZIMET NË PJESËMARRJE**

1. **Shtëpitë filmike dhe producentët** që janë me vonesë në zbatimin e kontratës me QKK-në për projektet e fituara më parë, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje.
2. Shtëpitë filmike nuk kanë të drejtë pjesëmarrje me më shumë se dy projekte brenda vitit, projektet duhet të jenë të kategorive të ndryshme.
3. Një producent ka të drejtë të aplikojë me vetëm një projekt brenda vitit.
4. Një regjisor ka të drejtë të aplikojë me vetëm një projekt brenda vitit.
5. I njejt person nuk mund të jetë regjisor dhe producent i të njejtit projekt.

6. Regjisorët të cilët nuk e kanë përfunduar fazën e xhirimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje.
7. Personat që aplikojnë në cilësinë e regjisorit në një projekt, nuk kanë të drejtë të aplikojnë në cilësinë e producentit në një projekt tjetër dhe anasjelltas.
8. Filmat televiziv të metrazheve dhe zhanreve të ndryshme nuk kanë të drejtë pjesëmarrje/aplikimi.
9. Projektet që janë refuzuar dy herë nuk kanë të drejtë aplikimi.
10. Si dhe kriteret tjera të parapara me rregulloren për subvencionimin e projekteve filmike të QKK-së.

Data e fundit për aplikim: **04. Maj. 2018**

Pagesa e aplikimit duhet të bëhet për:

**Qendra Kinematografike e Kosovës**

**BPB – Banka për Biznes**

Nr. i xhirlogarisë: **1300 0010 0144 0310**